



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

VENDIM
Nr. 355, datë 11.07.2024

PËR
PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË
KËSHILLTARES LIGJORE NË NJËSINË E SHËRBIMIT LIGJOR PRANË
GJYKATËS SË LARTË ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 34 dhe 80 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në nenin 16 të Vendimit të tij nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V Ë R E N:

I. PROCEDURA

1. Znj. {...} ka depozituar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesë datë 01.07.2024, protokolluar me tonën nr. 3450 Prot., datë 01.07.2024, me anë të së cilës parashtron kërkesë për dorëheqje nga detyra e Këshilltarit Ligjor pranë Njesisë së Shërbimit Ligjor, në Gjykatën e Lartë, referuar ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Bazuar në të dhënat që disponon Drejtoria e Burimeve Njerëzore, znj. {...}, nëpunës civilë gjyqësor, referuar ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 50, shkronja b, në pozicionin Këshilltar Ligjor në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, e datëlindjes 09.02.1963, në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, mbush moshën për pension të plotë pleqërie më datë 09.10.2024. Megjithatë, znj. {...} paraqet kërkesën e ligjshme, referuar vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

II. VLERËSIME MBI PËRFUNDIMIN E MARRËDHËNIES NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR TË ZNJ. {...}

3. Këshilli, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka në kompetencë të tij ndër të tjera ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin e këshilltarit ligjor. Në nenin 12, pika 1 të vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet se: “1. Marrëdhënia e shërbimit civil gjyqësor ndërpritet me vendim të: a) Këshillit të Lartë Gjyqësor për Kancelarin, Këshilltarin dhe Ndhmësin Ligjor”.
4. Referuar nenit 16 të vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcaktohet se: “Nëpunësi civil gjyqësor mund të njoftojë përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes me shkrim tek Këshilli i Lartë Gjyqësor për Kancelarët, Këshilltarët dhe Ndhmësit Ligjor dhe tek Këshilli i Gjykatës për nëpunësit e tjerë. 2. Dorëheqja nuk motivohet dhe i prodhon efektet 30 ditë nga data e paraqitjes së saj. 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar të nëpunësit civil gjyqësor dhe me miratimin e organeve kompetente të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, dorëheqja i prodhon efektet përpara afatit 30-ditor nga njoftimi. 4. Nëpunësit civilë gjyqësorë, të cilët janë larguar nga shërbimi civil gjyqësor si pasojë e dorëheqjes, kanë të drejtë që të konkurrojnë si nëpunës civilë gjyqësorë për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas ligjit “Për nëpunësit civil”, deri në 2 vjet pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”. Referuar kësaj dispozite, rezulton se një ndër rastet e përfundimit për shkak të ligjit, të marrëdhënies në shërbim civil gjyqësor, është paraqitja e kërkesës së dorëheqjes me shkrim.

III. KONKLUZIONI

5. Sa më sipër, mbështetur në nenin 80 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenin 16 vendimit nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe kërkesën e ligjshme të znj. {...}, vlerësohet përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor, më datë 31.07.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 90 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 34 dhe 80 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në nenin 16 të Vendimit të tij nr. 289, datë 05.06.2024 “Mbi miratimin e rregullores “Për pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor”, pasi shqyrtoi relacionin dhe materialet përkatëse, mbi propozimin e Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

VENDOSI:

1. Përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil gjyqësor të znj. {...}, këshilltare ligjore në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë, për shkak të dorëheqjes.
2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 31.07.2024.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar i njoftohet znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar dhe Gjykatës së Lartë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR